



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës - Gjakovë

01 Nr. /2021

Datë: 31.05.2021

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 dhe 40.2 shkronja i të Ligjit nr. 03/L040 për vetëqeverisje Lokale, dhe nenit 18.2 shkronja i të Statutit të Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 31.05.2021, pas diskutimit lidhur me pikën e 6 të rendit të ditës: Ndryshimi dhe plotësimi i Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve në Komunën e Gjakovës, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe Plotësohet përbërja e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për Emërtimin e Rrugëve në territorin e Komunës së Gjakovës e caktuar me vendimin 01 nr.012/01-7234 i datës 27.02.2020 ashtu që Komisioni do ta ketë këtë përbërje :

1. Z. Shaban Luma , përfaqësues i AAK-së
2. Znj. Teuta Pallaska Milla , përfaqësuese e AAK-së
3. Z. Ali Tafarshiku, përfaqësues i Alternativ-vë
4. Z. Liridon Dula, përfaqësues i PDK-së
5. Z. Sadik Hoti, përfaqësues i LDK-së
6. Znj. Mimoza Shala , përfaqësuese e VV-së
7. Z. Zef Komani, përfaqësues i PSHDK-së
8. Z. Demë Avdijsa, përfaqësues i NISMA-së
9. Z. Lulzim Haxhia , ekspertë i fushës

2. Ky Komision në bashkëpunim me Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, duhet të veprojë në harmoni me dispozitat e Ligjit për Sistemin e Adresave, dhe të ju jepe përgjigjeje ankesave dhe kërkesave të drejtuara për emërtimin e rrugëve .

4. Pas përfundimit të punës së këtij komisioni emrat e propozuara të paraqiten në Kuvend për shqyrtim dhe miratim .

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

6. Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjini
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
- Anëtarëve të Komisionit
- Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

z. Anton Shala